



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.202\_\_

**V E N D I M**

**Nr. 319 datë 21.07.2022**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...},**

**PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,  
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQJAR, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 21.07.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022,

**V Ë R E N**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Znj. {...} është candidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

- a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 15.04.2021, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);
- b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 14.05.2021, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 365/1 prot., datë 14.05.2021 (protokolluar në Këshill me aktin nr. 2222 prot., datë 14.05.2021).

2. Me Vendimin nr. 218, datë 26.05.2021, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2021-2022*, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit *për kandidaten znj. {...} si relator u caktua znj. Marçela Shehu*.

3. Më datë 26.05.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditë, kandidatja, znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 01.06.2021, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates, znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja, znj. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditë (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 07.06.2021, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të

figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidatja në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e saj në punë (punësimin), si dhe në ato të marra nga organet e sigurimeve shoqërore (me Shkresën nr. 3692/1 prot., datë 14.06.2021, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 23.02.2022, relatorja e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 23.02.2022 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatës {...} për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

### **A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat**

12. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidaten {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30<sup>1</sup> ("Kandidimi dhe vlerësimi

---

<sup>1</sup> "1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla

paraparak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraparak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 15.04.2021, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidatja {...}.

13. Gjithsesi, për kandidaten {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

13.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2021), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (Prill 2021), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2021). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

13.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”), pika 4/1<sup>2</sup>, shkronja “ç”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e

---

*e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraparak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraparak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse".*

<sup>2</sup> “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”.

emërimin të të diplomuarve për magistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

#### 14. Konkretisht, për kandidaten u verifikua:

*a) zotësia e plotë për të vepruar.* Për kandidaten nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

*b) shtetësisë shqiptare.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentin “letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 11.07.2012, në të cilin përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit për kandidaten nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 23.06.2021, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

*c) gjendja gjyqësore.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 29.01.2021, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidates, u administruan Shkresa nr. 6269/1 prot., datë 17.06.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja nuk ka shënime në sistem;

*ç) disiplina në punë.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, nr. Regj. Them. 128, ndërkohë që gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr. 4329/1 prot. datë 23.06.2021, e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier; Shkresa nr. 713/1 prot. datë 22.06.2021, e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier; shkresa nr. 41 prot. datë 09.06.2021 e Shoqërisë “Myrto Security” sh.p.k. Fier; Shkresa nr. 5689/1 prot. datë 02.07.2021, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier.

ç.1) Sipas këtyre dokumenteve rezulton se kandidatja është larguar nga puna por ajo nuk ka masë disiplinore në fuqi. Kandidatja ka ushtruar të drejtën e padisë ndaj urdhërit të largimit nga puna, nga punëdhënësi ish Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Nga shqyrtimi gjyqësor i padisë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 34 datë 20.01.2014 ka vendosur : “1. Pranimin e pjesshëm të padisë. 2. Detyrimin e palës së paditur ZQRPP dhe ZVRPP Fier të dëmshpërblejë paditësen {...} me 8 (tetë) paga mujore...për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me efekt të menjëhershëm pa shkaqe të justifikuara. 3. Detyrimin e palës së paditur ZQRPP dhe ZVRPP Fier të dëmshpërblejë paditësen

{...} me 2 (dy) paga mujore...për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit. 4. Detyrimin e palës së paditur ZQRPP dhe ZVRPP Fier të dëmshpërblejë paditësen {...} me 2 (dy) paga mujore...për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit. 5. Detyrimin e palës së paditur ZQRPP dhe ZVRPP Fier të dëmshpërblejë paditësen {...} me 2 (dy) paga mujore...si shpërblim për vjetërsi në punë. 6. Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera të kërkit.

7. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur. 8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij”.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar e drejta e ankimit nga pala e paditur, dhe pas shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë me vendimin nr. 1994 datë 21.05.2014 ka vendosur :

1. Ndryshimin e vendimit nr. 34 datë 20.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë :
  - Pranimin e pjesshëm të padisë.
  - Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësës {...}, dëmshpërblimet dhe shpërblimin për vjetërsi në punë, mbi bazën e pagës neto, të përfituar prej saj në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
  - Lënien në fuqi të vendimit për disponimet e tjera.
  - Shpenzime gjyqësore nuk ka.
  - E drejta e rekursit kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit palëve ndërgjyqëse.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar e drejta e rekursit nga pala e paditur, dhe pas shqyrtimit, Gjykata e Lartë, Kolegji Administrativ Tiranë me vendimin nr. 2446 datë 13.12.20217 ka vendosur : “Mospranimin e rekursit të palës së paditur Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, kundër vendimit nr. 1994 datë 21.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.

ç.2) Ndërkohë, gjatë verifikimit mbi të dhënat në dokumentin “Librezë Pune”, nr. Regj. 128 Them., të depozituar nga kandidatja, në lidhje me të dhënat e ardhura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 3692/1 prot., datë 14.06.2021 rezultoi se kandidatja ka qenë në marrëdhënie pune për periudhën korrik 2014 – korrik 2015 pranë Kompanisë Stream Oil & Gas LTD dhe Transatlantic Albania LTD dega shqiptare. Kjo periudhë nuk figuron e pasqyruar në dokumentin “Librezë Pune”, nr. Regj. 128 Them., të depozituar nga kandidatja.

ç.2).1 Sa rezultoi më sipër, u kërkua informacion mbi të dhënat e punësimit të kandidatës pranë Kompanisë Stream Oil & Gas LTD dhe Transatlantic Albania LTD dega shqiptare.

ç.2).2 Nga ana e Këshillit nuk u bë e mundur marrja e informacionit mbi të dhënat e punësimit të kandidatës pranë Kompanisë Stream Oil & Gas LTD dhe Transatlantic Albania LTD dega shqiptare, për arsye se adresa e kësaj kompanie ishte e panjohur për shërbimin postar.

ç.3) Lidhur me këtë fakt, mbi të dhënat e punësimit pranë Kompanisë Stream Oil & Gas LTD dhe Transatlantic Albania LTD dega shqiptare si dhe adresën e kësaj kompanie, u kërkuan sqarime nga kandidatja znj. {...}.

ç.3).1 Kandidatja në rrugë elektronike në sqarimet e saj deklaroi se ka qenë në marrëdhënie pune pranë Kompanisë Stream Oil & Gas LTD dhe Transatlantic Albania LTD dega shqiptare, ndërsa lidhur me adresën e kësaj kompanie në dijeninë e saj kishte kaluar në process shitblerje.

Kandidatja sqaroi se ka qenë në marrëdhënie pune pranë kësaj kompanie deri në shkurt 2015 kur ka filluar dhe lejen e barrëlindjes. (Kandidatja depozitoi certifikatë familjare ku provohet fakti se fëmija i dytë është i dtl. 02.02.2015). Për këtë arsye dhe dokumenti “librezë pune” i depozituar prej saj është pa këto të dhëna, pasi ka ndërprerë lejen dhe ka filluar marrëdhëniet e punës në një kompani tjetër P&P People, ndërkohë që kompania ka filluar procedura shitblerje. Gjithashtu ajo sqaroi se shtetasi Naim Kasa, përfaqësuesi ligjor i kësaj kompanie, është arrestuar nga “Akciza” biznesmeni në fushën e hidrokarbureve.

Deklarimi i kandidatës përputhet me të dhënat e ardhura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 3692/1 prot., datë 14.06.2021 ku rezultoi se kandidatja ka qenë në marrëdhënie pune për periudhën korrik 2014 – korrik 2015 pranë Kompanisë Stream Oil & Gas LTD dhe Transatlantic Albania LTD dega shqiptare, e në vijim pranë Kompanisë P&P People për periudhën korrik 2015 – dhjetor 2016.

ç.4) Sa sipër, mbi të dhënat e Kompanisë Stream Oil & Gas LTD dhe Transatlantic Albania LTD dega shqiptare si dhe adresën e kësaj kompanie, u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 2675/67 prot., datë 15.10.2021, nëse ky subjekt vijonte të kryejë aktivitet ekonomik financiar dhe nëse po, në çfarë adrese realizohej ky aktivitet.

ç.4).1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 9654/1 prot., datë 03.11.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2675/72 datë 05.11.2021 konfirmoi se referuar sistemit tatimor subjekti Transatlantic Albania LTD dega shqiptare rezulton me status “pasiv” që prej datës 26.08.2019.

*d) mosqenia bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 22.02.2021 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatës bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

16. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) *pasjen e kriterit arsimor*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentet: “Diplomë në Drejtësi”, me nr. 10806, datë 10.08.2008, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë si dhe Vërtetim notash datë 12.07.2008;

b) *pasjen e përvojës profesionale*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “Librezë Punë”, pas përfundimit të studimeve në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale aktive në administratën publike me kohë të plotë, në profesionin “specialiste/juriste”, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier (ish ZVRPP Fier) për periudhën 23 prill 2009 – 22 nëntor 2013 dhe 08 korrik 2015 – 31 dhjetor 2016; pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier për periudhën 14 shtator 2018 – 13 dhjetor 2018; pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier për periudhën 21 korrik 2020 e në vijim; përveç se ajo ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë edhe në sektorin privat, konkretisht si “juriste” pranë Shoqërisë “Myrto Security” sh.p.k. Fier për periudhën 04 maj 2018 – 19 gusht 2018;

c) *mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 22.02.2021, në të cilën deklaron se nuk është anëtare e ndonjë partie politike;

ç) *mosqenien anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 22.02.2021 në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së saj (e datëlindjes 02.08.1985), ajo nuk mund të ketë qenë e tillë.

## **B. Për kriterin e pasurisë**

17. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: “1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë ...”.

18. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet publike kompetente të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit. Ky raportim, krahas kandidates, u kërkua edhe për bashkëshortin e saj, z. Neritan {...}, si person i lidhur me të në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e



konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (nenet 3 dhe 5), si dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (neni 2).

18. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 520/23 prot., datë 26.07.2021.

18.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} dhe personi i lidhur me të kanë plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

18.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidatja {...}, dhe personi i lidhur me të, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18.3 Bazuar në rezultatet e këtij raporti, në kuadër të verifikimit të mëtejshëm të kriterit të pasurisë, kandidates znj. {...} iu kërkuan sqarime lidhur me burimin e krijimit të një ndër pasurive të deklaruara prej saj në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, një apartament banimi në qytetin Fier, blerë me kontratën e shitjes datë 30.09.2013, në shumën 5.800.000 lekë, ku si burim të krijimit të kësaj pasurie ka deklaruar kursimet deri në vitin 2013, nga të ardhurat familjare, duke përfshirë dhe kursimet e prindërve të bashkëshortit.

18.4 Në përgjigje të sqarimeve të kërkuara kandidatja parashtroi se burimi i krijimit të kësaj pasurie sikurse e ka deklaruar dhe më parë janë “kursimet deri në vitin 2013 nga të ardhurat familjare”. Kontributi ka qenë i gjithë familjes sipas gjendjes familjare në momentin kur është krijuar kjo pasuri, ashtu sikurse është deklaruar edhe nga bashkëshorti i saj si subjekt deklarues në ILDKPKI, duke theksuar të pasurit me arsim të lartë të anëtarëve të familjes së origjinës së bashkëshortit dhe me paga të kënaqshme në atë periudhë. Për shkaqe të posaçme ngushtësisht familjare, në momentin e shkëputjes nga përbërja familjare, pasuria është regjistruar në emrin e kandidates dhe të bashkëshortit, me pëlqim të plotë dhe pa asnjë objeksion nga familjarët e origjinës së bashkëshortit.

18.5 Sa është referuar në deklaratimet e saj kandidatja depozitoi çertifikatë lidhur me përbërjen familjare të vitit 2013.

18.6 Gjithashtu, kandidates iu kërkua të vihej në dispozicion të Këshillit një kopje të aktit të fitimit të pronësisë të apartamentit të banimit me nr. Pasurie 6/12+1-6 në emër të prindërve të bashkëshortit të saj.

18.6.1 Kandidatja sqaroi se pasuria e familjes së bashkëshortit të saj është jashtë regjimit pasuror që ka ajo dhe bashkëshorti, ndaj dhe informacioni lidhur me pasuri të tyre kërkoi të trajtohen në respektim të së drejtës së tyre për privatësi dhe brenda një vlerësimi logjik dhe të arsyeshëm, duke bashkëlidhur aktet : 1. Kontratën për privatizimin e banesës (Formulari nr.3); 2 Vërtetim të regjistrimit të kontratës në regjistrin hipotekor; 3. Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme me nr. 6/212+1-6 .

18.7 Lidhur me informacionin e kërkuar nga Këshilli se cili është burimi i krijimit të pasurisë në emër të prindërve të bashkëshortit të saj, kandidatja sqaroi se burimi i krijimit të kësaj pasurie është ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

19. Në kuadër të verifikimit të mëtejshëm të kriterit të pasurisë së kandidates znj. {...}, iu kërkua ILDKPKI-së të vinte në dispozicion deklaratat periodike ndër vite, së bashku me dokumentet shoqëruese, të subjektit deklarues Neritan Kujtim {...}, bashkëshorti i kandidates. Gjithashtu u kërkua informacion nëse nga ana e këtij institucioni është kryer kontroll i plotë i deklaratave periodike të këtij subjekti, dhe nëse po, të vihej në dispozicion një kopje të raportit përkatës.

19.1 Nga ILDKPKI-ja, u depozituan në Këshill me shkresën nr. 2941/38 prot., datë 15.12.2021, Deklaratat e Interesave Private të depozituara nga subjekti Neritan {...}, bashkëshorti i kandidates, për periudhën : para fillimit të detyrës 2007, periodik vjetor 2007 – 2013, pas përfundimit të detyrës 2014.

19.2 Nga materiali i depozituar, rezulton se nga ana e këtij institucioni nuk është kryer kontroll i plotë i deklaratave periodike të këtij subjekti, pasi nuk është vënë në dispozicion një kopje të raportit përkatës.

20. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

20.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10493/1 prot., datë 25.06.2021, ku për kandidaten {...} dhe për personin e lidhur me të, nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare dhe nuk rezulton të jenë të regjistruar në organet tatimore.

20.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10356/1 prot., datë 30.06.2021, ku për kandidaten {...} dhe për personin e lidhur me të, nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

21. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por edhe institucionet e tjera të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar kësaj të fundit bërja e një kontrolli dhe raportimi shtesë.

22. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj, patur parasysh për këtë përcaktimin e shkronjës “a”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: *“4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asetë duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të asetëve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”*. Konkretisht, për kandidaten u verifikua që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidatja i pasurisë, asetëve ose të interesave privatë, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

### **C. Për kriterin e figurës**

23. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të ... figurës”*.

24. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

25. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

26. Nga informacioni i ardhur nga Byroja Kombëtare e Hetimit me shkresën nr. 276/1 prot. datë 28.06.2021, në përgjigje të kërkesës së Këshillit, rezulton se për kandidaten {...} nuk ka informacion.

27. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkua dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 04.06.2021, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

28. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 2287/1 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2619/1 datë 12.07.2021, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

29. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) sipas shkronjës “c”, pika 12, e këtij relacioni, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidatja: - *ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 04.06.2021*; - *formulari është regjistruar me numrin unik 000575*; - *vetëdeklarimi është bërë publik, në faqen zyrtare ëeb të KLGJ-së*; - *në formular, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuar me ligj*; - *nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk kanë rezultuar ndryshime të të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara*; - *deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme*”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

30. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 924/25 prot., datë 08.09.2021, protokolluar me aktin nr. 2674/1, datë 08.09.2021, përgjigjet zyrtare të 22 (njëzet e dy) prokurorive. Gjithashtu, mbi kërkesën e Këshillit, u administrua dhe përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcjellë me Shkresën nr. 6161/1 prot., datë 03.09.2021, protokolluar në Këshill me aktin

nr. 3785/1, datë 07.09.2021. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezulton se për kandidaten {...}, nuk rezulton që ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, që ajo të ketë qenë ose të jetë nën hetim, që ndaj saj të jetë caktuar ndonjë masë sigurimi ose që ajo të jetë dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale.

31. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj, patur parasysh përcaktimet e shkronjave “b” dhe “c”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilave: “4/1. *Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të .. figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që çënojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; ...*”. Konkretisht, për kandidaten u verifikua që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruar, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;
- ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë, bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të saj, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cenim të besimit publik në sistemin gjyqësor dhe, për rrjedhojë, mbi pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.

### **III. KONKLUZIONE**

32. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

33. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2021-2022.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **V E N D O S I:**

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2021-2022.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**